



Prof. Isak Hoxha

(1947-2025)

Lindi më 28.02.1947 në Zhur të Prizrenit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa shkollën normale në Prizren (1967). Ka diplomuar në degën e matematikës të FSHMN (1971). Studimet pasuniversitare i vijoi në FSHMN në Zagreb (1971-1973). Në vitin 1973 zgjedhet asistent në Fakultetin Teknik të UP. Ka magjistruar në lëmin e Analizës funksionale (1982). Është zgjedhur ligjërues në FNA të UP (1982). Në periudhën 1987-1988 ka qëndruar në vizitë studimore në Minsk, për përgatitjen e tezës së doktoratës. Ka doktoruar në lëmin e analizës funksionale (1989) në FSHMN të UP. Është zgjedhur në thirrje të docentit (1990), profesorit inordinar (1993) dhe profesor ordinar (2003), në të njëjtin fakultet. I. Hoxha ka ligjëruar një numër të madh të kurseve në FNA, FSHMN, Universitetin Shtetëror të Tetovës, Fakultetin Xehtar-Metalurgjik në Mitrovicë, Fakultetin e Bujqësisë, Universitetin e Prizrenit dhe në kolegje private. Ka qenë i angazhuar edhe në studimet pasuniversitare në Fakultetin Teknik. Ka qenë pjesëmarrës në tubime shkencore në Zagreb, Shkup, Minsk, Dubrovnik. I. Hoxha ka qenë autor i shumë punimeve shkencore si dhe është autor i disa teksteve universitare. Ka qenë shef në katedrën e matematikës (1990-2012) të FNA dhe laureat i mirënjohjes së punës në të njëjtin fakultet (2005).